



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E ARSIMIT  
SPORTIT DHE RINISË

Nr. 7522 prot.  
datë 12.07.2018

MINISTRIA  
E BRENDSHME

Nr. 8629 prot.  
datë 22.10.2018

MINISTRIA  
E SHËNDETËSISË  
DHE MBROJTJES SOCIALE

Nr. 6084 prot.  
datë 23.10.2018

MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

NDËRMJET

MINISTRISË SË ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË

MINISTRISË SË BRENDSHME

DHE

MINISTRISË SË SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE

“PËR IDENTIFIKIMIN DHE REGJISTRIMIN NË SHKOLLË  
TË TË GJITHË FËMIJËVE TË MOSHËS SË DETYRIMIT SHKOLLOR”

Mbështetur në nenin 57 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në germën e të nenit 25 të ligjit nr. 69/2012, datë 21.06.2012 "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, dhe në pikën 4 të nenit 20 e në pikën 5 të nenit 24 të ligjit nr. 18/2017, datë 23.02.2017 "Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës", Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Ministria e Brendshme, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, që më poshtë do të quhen "Palë", lidhin këtë Marrëveshje Bashkëpunimi për identifikimin dhe regjistrimin në shkollë të të gjithë fëmijëve të moshës së detyrimit shkollor.

## **I. OBJEKTI I MARRËVESHJES**

Objekti i kësaj Marrëveshjeje është:

1. Përfshirja e të gjitha institucioneve për sigurimin e ndjekjes së arsimit bazë nga të gjithë fëmijët e moshës së detyrimit shkollor.
2. Koordinimi i njësive arsimore vendore (më tutje NjAV) dhe shkollave me njësitë e vetëqeverisjes vendore, zyrat e gjendjes civile, njësitë e mbrojtjes së fëmijëve (më tutje NjMF) dhe qendrat shëndetësore për identifikimin dhe regjistrimin në shkollë të të gjithë fëmijëve të moshës së detyrimit shkollor.

## **II. QËLLIMI I MARRËVESHJES**

Kjo Marrëveshje ka si qëllim identifikimin dhe regjistrimin në shkollë të të gjithë fëmijëve të moshës së detyrimit shkollor.

## **III. DETYRIME TË PËRBASHKËTA**

Palët pjesë e kësaj Marrëveshjeje kanë këto detyrime të përbashkëta:

1. Komunikojnë në mënyrë të vazhdueshme nëpërmjet punonjësve të ngarkuar me këtë përgjegjësi.
2. Organizojnë takime të përbashkëta, jo më pak se një herë në vit dhe sa herë të çmohet e nevojshme, për të analizuar problematikat e konstatuara dhe për të gjetur zgjidhjet për to.
3. I dërgojnë njëra-tjetrës informacione në formë shkresore dhe/ose elektronike për problemet që lindin gjatë zbatimit të Marrëveshjes.

## **IV. DETYRIMET E PALËVE**

### **IV.1. Detyrimet e Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë**

Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë (më tutje MASR) ngarkon Qendrën e Shërbimeve Arsimore (më tutje QShA), NjAV-të dhe shkollat e arsimit bazë me këto detyra:

1. MASR-ja, brenda datës 1 mars nxjerr urdhrin për strukturën e vitit shkollor.
2. MASR-ja ngarkon dhe mbikëqyr QShA-në për t'i dërguar NjAV-ve listën emërore të fëmijëve të moshës së detyrimit shkollor për vitin e ardhshëm shkollor.
3. NjAV-ja u dërgon listën e parashikuar në pikën 2 të gjitha shkollave të arsimit bazë publike dhe private që ka në juridiksion, brenda muajit maj.
4. Drejtorët e shkollave të arsimit bazë, publike dhe private, në fund të periudhës së regjistrimit në shkollë, i dërgojnë NjAV-së përkatëse listat emërore të fëmijëve të regjistruar në shkollat e tyre.
5. NjAV-ja harton listën e fëmijëve që nuk janë regjistruar në shkollat e arsimit bazë, publike dhe private, që ka në juridiksionin e saj.
6. NjAV-ja, brenda muajit shtator, i dërgon listën e parashikuar në pikën 5, ndërlidhësit komunitar / kryetarit të fshatit përkatës dhe inspektorit të policisë së zonës.
7. NjAV-ja, brenda datës 15 tetor, u dërgon shkollave publike të dhënat e ndërlidhësve komunitarë/kryetarëve të fshatrave dhe të inspektorëve të policisë së zonave.
8. Shkollat publike identifikojnë fëmijët, që i përkasin zonës së tyre, i regjistrojnë ata brenda datës 31 tetor dhe informojnë zyrtarisht NjAV-në përkatëse.
9. NjAV-të dhe shkollat bashkëpunojnë me organizatat jofitimprurëse, që veprojnë në fushën e arsimit, dhe me njësitë e vetëqeverisjes vendore për zbatimin e detyrimit shkollor sipas ligjit nr. 69/2012, datë 21.06.2012 "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, dhe ligjit nr. 18/2017, datë 23.02.2017 "Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës".



## **IV.2. Detyrimet e Ministrisë së Brendshme**

Ministria e Brendshme (më tutje MB) ngarkon zyrat e gjendjes civile, ndërlidhësit komunitarë / kryetarët e fshatrave dhe inspektorët e policisë së zonës me këto detyra:

1. MB-ja, në fillim të muajit prill, i dërgon MASR-së listën emërore të fëmijëve të moshës së detyrimit shkollor për vitin e ardhshëm shkollor.
2. Ndërlidhësi komunitar/ kryetari i fshatit gjen në listën e fëmijëve ende të paregjistruar, që i dërgohet nga NjAV-ja, fëmijët në moshë të detyrimit shkollor që i përkasin zonës që mbulon dhe që duhet të regjistrohen në një shkollë të NjAV-së. Emrat e fëmijëve shoqërohen me vendndodhjet e tyre.
3. Inspektori i policisë, gjen në listën e fëmijëve ende të paregjistruar, që i dërgohet nga NjAV-ja, fëmijët që i përkasin zonës që mbulon dhe i dërgon NjAV-së përkatëse emrat e fëmijëve dhe vendndodhjen e tyre.
4. Institucioni i Prefektit ka rol koordinues ndërmjet institucioneve lokale dhe vihet në dijeni për përcjelljen dhe mbledhjen e listave të fëmijëve për verifikim në terren.

## **IV.3. Detyrimet e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale**

Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (më tutje MShMS) ngarkon qendrat shëndetësore, drejtoritë e shëndetit publik dhe Agjencinë Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës me këto detyra:

1. Qendra shëndetësore dërgon brenda muajit prill në Drejtorinë e Shëndetit Publik, nga e cila varet, listën e fëmijëve që duhet të regjistrohen në klasën e parë për vitin e ardhshëm shkollor, duke pasur parasysh datën e fillimit të vitit shkollor.
2. Drejtoria e Shëndetit Publik/ Drejtoria Rajonale e Shëndetësisë/ AShR-ja Tiranë i dërgon NjAV-së përkatëse, brenda muajit prill, listën emërore të fëmijëve që duhet të regjistrohen në klasën e parë për vitin e ardhshëm shkollor, duke pasur parasysh datën e fillimit të vitit shkollor.
3. Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës dhe NjMF-të në nivel njësie të vetëqeverisjes vendore kryejnë këto detyra:
  - a) Bashkëpunojnë me shkollat dhe ndihmojnë në identifikimin e fëmijëve që kanë mbushur moshën e detyrimit shkollor, por nuk e ndjekin shkollën.
  - b) Bashkëpunojnë me shkollat publike për regjistrimin e fëmijëve që kanë mbushur moshën e detyrimit shkollor, por nuk e ndjekin shkollën.
  - c) Informojnë zyrtarisht NjAV-në përkatëse për fëmijët jashtë sistemit arsimor dhe në situatë rruge.

## V. DISPOZITA KALIMTARE

Palët bien dakord që nga hyrja në fuqi e kësaj Marrëveshjeje të miratojnë rregulloren e përbashkët për zbatimin e Marrëveshjes, duke detajuar përgjegjësitë e secilës ministri dhe të strukturave të vartësisë së tyre.

Palët hartojnë dhe miratojnë, brenda një muaji nga nënshkrimi i kësaj Marrëveshjeje, rregulloren për zbatimin e saj.

## VI. AFATI, NËNSHKRIMI DHE ZGJIDHJA E MARRËVESHJES

1. Kjo Marrëveshje Bashkëpunimi hyn në fuqi me nënshkrimin e Palëve dhe është e vlefshme deri në rastin kur lind nevoja për rishikimin e saj ose kur njëra nga palët kërkon prishjen e Marrëveshjes, por vetëm pas njoftimit paraprak prej 30 ditësh.
2. Marrëveshja nënshkruhet në tri kopje, në gjuhën shqipe dhe të barasvlershme.

Nënshkruar në Tiranë, më 12.07.2018

MINISTRIA E ARSIMIT  
SPORTIT DHE RINISË

Lindita NIKOLLA



MINISTRIA  
E BRENDSHME

Fatmir XHAFAJ



MINISTRIA  
E SHËNDETËSISË  
DHE MBROJTJES SË SHPIRIT  
DHE MBRUTJES

Ogerta MANASTIRLIU

